VENDIM
Nr. 143, datë 13.2.2020

PËR PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT, PËR SUBJEKTET E RINDËRTIMIT DHE PËR PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR TË FURNIZIMIT TË MALLRAVE E SHËRBIMEVE, PËR QËLLIME TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 53, shkronjat "l" e "ll", dhe 56, pika 28, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Neni 1

Përjashtimi nga TVSH-ja i furnizimit të procesit të ndërtimit, i kryer nga subjekte të autorizuara të rindërtimit, dhe i furnizimit të mallrave e shërbimeve që përdoren prej tyre vetëm për qëllime të rindërtimit

Bazuar në nenet 53, shkronjat "l" e "ll", dhe 56, pika 1, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), brenda programit dhe përgjatë periudhës së rindërtimit për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", sipas përcaktimeve në legjislacionin e rindërtimit:

a) furnizimi i procesit të ndërtimit, që realizohet nga ndërtuesit, subjekte të rindërtimit;

b) furnizimi i shërbimeve dhe mallrave për procesin e ndërtimit, i kryer direkt për ndërtuesit, subjekte të rindërtimit;

c) importimi i mallrave për procesin e ndërtimit, i kryer direkt nga ndërtuesit, subjekte të rindërtimit.

Neni 2

Procesi i rindërtimit dhe programet e tij, për të cilat zbatohen përjashtimet nga TVSH-ja

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 97/2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH-ja janë:

a) Programi i ndërtimit të objekteve në zonat e reja apo në të njëjtin truall, që përfshin:

i. ndërtimin e objekteve të reja dhe të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore;

ii. ndërtimin e objekteve të reja dhe të infrastrukturës publike nga donatorët;

iii. rindërtimin e ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall.

b) Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike, kur nuk është pjesë e programeve të tjera të parashikuara në ligj, dhe të infrastrukturës kritike, me anë të të cilit, me financim nga fondi i rindërtimit apo nga donatorët, ndërtohen ose rikonstruktohen objekte të infrastrukturës publike dhe kritike nga njësitë zbatuese.

Neni 3

Subjektet e rindërtimit të autorizuara për përjashtimin nga TVSH-ja

Përjashtohen nga TVSH-ja:

a) ndërtuesit/kontraktorët, subjekte të rindërtimit, të cilët u nënshtrohen dispozitave të ligjit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë dhe përcaktimeve të këtij vendimi;

b) ndërtuesit/kontraktorët, subjekte të rindërtimit, të cilët duhet të kenë lidhur një marrëveshje kuadër me njësinë zbatuese, të ngarkuar nga Këshilli i Ministrave për administrimin e fondeve të shpërndara nga fondi i rindërtimit dhe që përdoren bazuar në procedurat e ligjit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, në lidhje me prokurimin publik për rindërtimin;

c) ndërtuesit/kontraktorët, subjekte të rindërtimit, të përcaktuar nga donatorët, për rastet kur donacionet/grandet e tyre nuk janë pjesë e fondit të rindërtimit sipas ligjit të buxhetit.

ç) nënkontraktorët, të cilët kanë lidhur kontrata me ndërtuesit/kontraktorët e përcaktuar në shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, për furnizimin e proceseve të ndërtimit, si dhe furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar.

(Shtuar me Vendim Nr. 804, datë 30.09.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184, datë 16.10.2020)

Neni 4

Për qëllime të zbatimit të përjashtimeve të mësipërme, subjektet e përcaktuara në nenin 3, të këtij vendimi, duhet të jenë të autorizuara nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Për t'u pajisur me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me shkrim, së cilës i bashkëlidhet një fotokopje e certifikatës së NIPT/NUIS-it;

b) Marrëveshjen kuadër, që kanë lidhur me njësinë zbatuese për secilën procedurë prokurimi publik të programit të rindërtimit, sipas parashikimeve në ligjin e fushës, në rastin e ndërtuesit/kontraktorëve;

c) Marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorit, në rastet kur ndërtuesi, subjekt i rindërtimit, është përcaktuar nga donatori që ka marrë përsipër procesin e ndërtimit, në përputhje me programin e rindërtimit;

ç) Preventivin e punimeve, mbi bazën e të cilit janë përzgjedhur fitues për kontratat publike për punime/shërbime ndërtimi, në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, shoqëruar kjo me listën e detajuar të materialeve që do të përdoren në procesin e ndërtimit, në rastin e ndërtuesit/nënkontraktorëve;

~~d) Kopjen e lejes së ndërtimit, të miratuar nga organet kompetente, në rastin e ndërtuesve;~~

dh) Kontratën e lidhur me ndërtuesin/kontraktorin, në rastin e furnizuesve të mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar, kontraktorë/nënkontraktorë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga subjektet e rindërtimit. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditor.

Bazuar në rezultatet e shqyrtimit, kur përmbushen kërkesat e përcaktuara dhe është plotësuar dokumentacioni i sipërpërmendur, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, lëshon autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja për subjektet e rindërtimit.

Një kopje e autorizimit, së bashku dokumentacionin shoqërues i përcillet drejtorisë rajonale tatimore përkatëse, që ka në administrim tatimpaguesin, subjekt të rindërtimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen zyrtare dhe mban të përditësuar listën e subjekteve të rindërtimit, të cilat janë pajisur me autorizim përjashtimi nga TVSH-ja, ku pasqyrohen të dhënat identifikuese të tatimpaguesit, NIPT/NUIS-i, numri dhe data e lëshimit të autorizimit.

Furnizuesit e mallrave/shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja për procesin e ndërtimit, në momentin e lëshimit të faturës tatimore duhet të shënojnë në faturë dispozitën ligjore, sipas së cilës furnizimi është i përjashtuar, si dhe numrin e datën e autorizimit të përjashtimit.

Gjithashtu, furnizuesi i bashkëlidh kopjes së faturës tatimore, që mban vetë, edhe një kopje të autorizimit të përjashtimit.

Asnjë përjashtim nuk akordohet për furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që nuk furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, të cilat i importojnë vetë mallrat që do të përdoren prej tyre për procesin e ndërtimit, pas marrjes së autorizimit të përjashtimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, paraqiten pranë autoritetit doganor për të përfituar përjashtimin në import për këto mallra.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton procedurë/manual të posaçëm, me qëllim kontrollin e zbatimit të përjashtimeve, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 804, datë 30.09.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184, datë 16.10.2020)
(Hequr me VKM Nr. 1108, datë 28.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 234, datë 30.12.2020)

Neni 5

Përjashtimi nga TVSH-ja në import i materialeve, pajisjeve, ndërtesave të parafabrikuara, të importuara nga organe shtetërore, organizata bamirëse dhe filantropike

Bazuar në pikën 28, të nenit 56, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", përjashtohen nga TVSH-ja në import materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara nga organet shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike për rindërtimin e zonave të fatkeqësive, në rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", brenda programit të rindërtimit.

Për qëllime të zbatimit të përjashtimit në import, organet shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike, që do të importojnë, pajisen me autorizim nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Për marrjen e këtij autorizimi, këto organe/organizata duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD):

- kërkesën me shkrim, ku të jetë evidentuar NIPT/NUIS;
- dokumentin e lëshuar nga njësia zbatuese ose nga organi kompetent përkatës, sipas legjislacionit për rindërtimin, ku provohet/vërtetohet se materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, sipas zërave dhe sasive përkatëse, janë të destinuara për rindërtimin e zonave të fatkeqësive, për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", brenda programit të rindërtimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda pesë ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton aplikimin për përjashtim. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditor. Me plotësimin e dokumentacionit, DPD-ja lëshon autorizimin për përjashtim, i cili regjistrohet në sistemin e saj informatik.

Neni 6
Organet zbatuese

Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 22, datë 24.02.2020

Ndryshuar me :

- Vendim Nr. 804, datë 30.09.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184, datë 16.10.2020
- Vendim Nr. 1108, datë 28.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 234, datë 30.12.2020